



**PËRMBLEDHJE MBI INDIKATORË, TREGUES DHE
TIPOLOGJI TË VEPRAVE PENALE NË FUSHËN E TATIM
TAKSAVE**

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
1 Metodologjia	3
2 Indikatorë të pastrimit të parave të lidhur me vepra penale në fushën e tatim taksave	5
A. Ndërveprimi dhe sjellja e klientit	5
B. Transaksione të pazakonta ose të dyshimta	6
C. Mënyra e operimit të biznesit	8
D. Burimi i fondeve dhe pasurisë	9
3 Tipologji dhe raste studimore	10
4 Referencat	19

Hyrje

Veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve bazuar në Vlerësimin e fundit (2019-2023) të Riskut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të realizuara nga Autoritetet Shqiptare, kanë rezultuar si një ndër kategoritë kryesore të veprave penale gjeneruese të ardhurash të paligjshme në vendin tonë. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, evazoni fiskal konsiderohet si veprimtaria e kundërligjshme që synon shmangien e pagesës së detyrimeve tatimore përmes deklarimeve të rreme, fshehjes së të ardhurave, ose mosrespektimit të rregullave të parashikuara nga legjislacioni fiskal. Nenet kryesore që trajtojnë evazionin fiskal në Kodin Penal të Shqipërisë, janë neni 180 ‘Fshehja e të ardhurave’ dhe neni 181 ‘Mospagimi i taksave dhe tatimeve’.

Evazoni fiskal dhe pastrimi i parave janë shpesh të lidhura ngushtë, pasi të ardhurat e fituara nga aktivitetet e evazionit fiskal kërkojnë të fshihen ose të legalizohen për të shmangur zbulimin nga autoritetet.

Nga perspektiva e organizmave ndërkombëtare mbi parandalimin e PP/FT vlen të përmendet, se Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) bëri një ndryshim të rekomandimeve përkatëse të saj në 2012 për të përfshirë evazionin fiskal si një vepër penale gjeneruese të ardhurash për pastrimin e parave dhe në vitin 2015 Direktiva 4 ‘Kundër Pastrimit të Parave’ e BE u kërkon shteteve anëtare të përfshijnë krimet tatimore, si vepra penale kryesore për pastrim parash.

1. Metodologjia dhe qëllimi

Ky dokument është hartuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), me qëllim paraqitjen në mënyrë të përmbledhur të indikatorëve, treguesve dhe tipologjive (kombëtare dhe ndërkombëtare) të lidhura me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve. Për realizimin e kësaj përmbledhje jemi mbështetur në analizimin e rasteve të trajtuara nga AIF¹, nga organet tatimore, në raporte ndërkombëtare si raporte të publikuara nga Egmont Group apo njësi homologe të tjera.

Ky dokument përshkruan indikatorë të lidhur me veprat penale në fushën e tatim taksave të lidhur ose jo me pastrimit të parave dhe përshkruan praktikën që mund të ndodhin në mënyrë të dyshimtë gjatë operacioneve financiare të subjekteve. Të dhënat dhe indikatorët janë të rëndësishëm për subjektet raportuese për të identifikuar aktivitetet e dyshimta dhe për të parandaluar pastrimin e parave dhe evazionin fiskal.

¹ Këto raste dhe të tjera gjenden të publikuara edhe në Raportet Vjetore, në faqen web të institucionit tonë.

Njohja dhe përdorimi i indikatorëve, treguesve dhe tipologjive, vjen në ndihmë të subjekteve raportuese për një sërë arsyes, si:

- Identifikimin e modeleve, sjelljeve të dyshimta në mënyrë sa më të efektshme;
- Raportimin e rasteve të dyshimta sa më cilësore duke ndihmuar në forcimin e sistemit të parandalimit të pastrimit të parave;
- Monitorimin e transaksioneve nëpërmjet integritetit të indikatorëve në sistemet e monitorimit që kanë në përdorim;
- Zhvillimin e një profili sa më gjithëpërfshirës të riskut të klientit.

Gjithashtu, vjen në ndihmë edhe të organeve ligjzbatuese, të inteligjencës duke marrë në konsideratë se indikatorët, tipologjitë e parashtruara mund të jenë tregues se diçka e pazakontë po ndodh kur nuk kemi një shpjegim të arsyeshëm, duke përmirësuar analizën dhe investigimin financiar.

Indikatorët janë parashtruar duke u mbështetur në komponentët, si më poshtë:

- Sjellja e klientëve, që nuk justifikojnë transaksionet e tyre ose nuk ofrojnë dokumente të mjaftueshme për të mbështetur burimin e fondeve të tyre.
- Transaksione të pazakonta, si depozita të mëdha në cash, transaksione me vlera të nënvlerësuara ose të fryra, dhe lëvizje të fondeve jashtë vendit pa justifikime të qarta.
- Përdorimi i strukturave komplekse të biznesit për të fshehur origjinën e fondeve, si dhe krijimi i bizneseve pa aktivitet real ekonomik ose huave të dhëna nga aksionarët pa arsye të qarta.
- Të dhëna, sjellje të dyshimta lidhur me burimin e fondeve dhe pasurisë.

Në funksion të kësaj përmbledhje janë vlerësuar të përfshihen edhe indikatorë në lidhje me veprën penale të mashtrimit me TVSH². Indikatorët nuk përbëjnë një listë shteruese duke marrë parasysh ndër të tjera, evoluimin e vazhdueshëm të procedurave për kryerjen e transaksioneve dhe mund të përdoren në kuadër të detektimit, raportimit, analizimit të rasteve potenciale të dyshimta.

² Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar.

2. Indikatorë të pastrimit të parave të lidhur me vepra penale në fushën e tatim taksave

Në kuadër të kësaj përmbledhje indikatorët do parashtrihen sipas kategorive të mëposhtme.



A. Ndërveprimi dhe sjellja e klientit

Sjellja e klientëve, në rastet kur nuk ju përgjigjen kërkesave/pyetjeve të subjektit raportues, ndonjëherë mund të jenë tregues fillestar i një anomalie. Gjatë ballafaqimit me klientët punonjësit e subjekteve mund të ndeshen me situata që ngrenë dyshime, si më poshtë:

- Kur klienti nuk jep shpjegime apo nuk paraqet dokumentacion në lidhje me transaksionet që kërkon të kryejë;
- Kur klienti paraqet informacion apo të dhëna që tregojnë se fondet që po përdoren nuk janë deklaruar siç duhet tek autoritetet tatimore ose financiare;
- Klienti shfaq shqetësime gjatë plotësimit të formularit për deklarim të dhënash pranë punonjësit të subjektit raportues (p.sh.: klienti pyet drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëse subjekti raportues do të deklarojë të ardhurat/fondet e tij tek autoritetet ligjzbatuese);
- Klienti këmbëngul që nuk duhet të kontaktohet drejtpërdrejt nga punonjësi i subjektit, dhe refuzon çdo formë kontakti ose komunikimi;
- Klienti kërkon diskrecion të pazakontë për transaksionet e tij;
- Klienti jo rezident hap një llogari për përfitim përkohësisht të shërbimeve dhe nuk ka ndonjë lidhje të dukshme me vendin, si dhe nuk tregon ndonjë interes për përfitimet apo detyrimet që ka;
- Vihet re një mospërputhje midis strukturës organizative të klientit kompani dhe/ose qëllimit të transaksioneve dhe dokumentacionit të regjistruar në dosje në kuadër të vigjilencës së duhur;
- Vihet re një mospërputhje midis strukturës organizative të klientit kompani dhe/ose objektit të veprimtarisë dhe kualifikimit profesional të stafit;
- Transferta në shtete me risk të lartë për PP/FT (p.sh.: Vende me lehtësira fiskale, vende për të cilat janë vendosur sanksione, etj.) nga një klient i ri;
- Klienti paraqet deklarata ose dokumente fiskale që në dukje janë të falsifikuara ose të rreme;
- Klienti është jo bashkëpunues në kuadër të paraqitjes së dokumentave/të dhënave për procesin e vigjilencës së duhur (qoftë në fazën e regjistrimit ose gjatë marrëdhënies);
- Klienti kërkon këshilla në lidhje me përfitimin e të ardhurave nga një vend i huaj, pa një justifikim të arsyeshëm ose tregtar në lidhje me origjinën e pasurisë;

- Klienti ka vështirësi për të përshkruar natyrën e biznesit të tij ose i mungojnë njohuritë e përgjithshme të veprimtarisë së biznesit;
- Klienti këmbëngul për kryerje transaksionesh në cash në mënyrë të pa shpjegueshme dhe pa një logjikë të ligjshme ekonomike;
- Klienti tregon gatishmëri të dukshme për të paguar tarifa, çmime ose komisione shumë më të larta për produkte, shërbime sesa nga ato që zakonisht aplikohen në treg;
- Të dhëna publike/burime të hapura për dyshime/procedime/dënime të individëve për vepra penale të lidhura me fushën e tatim taksave, brenda apo jashtë vendit.



B. Transaksione të pazakonta ose të dyshimta

Indikatorë që përmendim për këtë kategori janë:

- Kryerja e transaksioneve ku asetet, si: pasuri të paluajtshme, tituj financiarë, mallra luksi apo kuotat e biznesit, blihen ose shiten me çmime që janë dukshëm më të larta ose më të ulta krahasuar me vlerën e tyre reale në treg;
- Ndërprerje e menjëhershme e marrëdhënieve të biznesit (hapje llogaria, anulim kontrate, etj.) veçanërisht nëse ndodh menjëherë pasi është vendosur, e shoqëruar me kërkesa për likuidimin/tërheqjen e shumave të mëdha në cash ose për realizim të transfertave në favor të palëve të treta jashtë vendit;
- Depozitime të përsëritura në shuma të mëdha ose hua nga palë të tretë, në emër të individëve ose bizneseve të cilat kryejnë veprime modeste dhe që pasohen me urdhra pagesash për afërsisht me të njëjtat shuma, veçanërisht nëse transferohen jashtë vendit pa përshkrim se cilit detyrim apo kontratë i referohet;
- Rritja e konsiderueshme e depozitimeve nga një kompani, ndërkohë që nuk justifikohet me një rritje të aktivitetit të saj apo kapitalit;
- Debitime apo kreditime në shuma të mëdha në llogarinë/të bankare të mbajtura nga një kompani, të cilat nuk justifikohen me profilin ekonomik të klientit;
- Depozitime në cash nga një kompani, të cilat janë të larta krahasuar me kompanitë me qarkullim vjetor të ngjashëm brenda të njëjtit sektor;
- Përdorimi në nivele të larta i cash në një kompani, e cili normalisht nuk kryen aktivitet intensiv nëpërmjet parasë fizike dhe nuk ka paraqitur ndonjë justifikim tregtar ose të arsyeshëm;
- Akumulime nga depozitime në shuma të mëdha në llogari, që më pas transferohen në llogari jashtë vendit, duke kryer transaksione komplekse të pajustificuara nga aktiviteti i kompanisë së klientit;

- Depozitime në cash të konsiderueshme (në numër dhe në vlerë) nga kompanitë pa asnjë qëllim të dukshëm ekonomik, sidomos nëse brenda një afati të shkurtër kohor shumat e depozituara janë transferuar nga llogaria e klientit në një destinacion që nuk duket të ketë lidhje me aktivitetin e kompanive;
- Transaksione të njëpasnjëshme midis kompanive, ku fondet në fund ri-investohen në juridiksionin fillestar;
- Fondet tërhiqen nga llogaria e kompanisë dhe mund të depozitohen në llogarinë personale dhe transferohen jashtë vendit apo investohen në mjete financiare virtuale, me synimin për të devijuar dhe fshehur gjurmët e transaksioneve;
- Investime në pasuri të luajtshme dhe paluajtshme të cilat nuk justifikohen nga të ardhurat e deklaruara nga individit apo fitimet e deklaruara nga kompania (apo shoqëritë kanë pak kohë që operojnë në treg);
- Transaksione me qëllim të transferimit të aktiveve (pasuri të paluajtshme, aksione, pasuri të tjera të luajtshme, etj.) të kompanisë, në një shoqëri tjetër pa ndonjë arsye të dukshme ekonomike, dhe pastaj e mbyll aktivitetin e saj apo shpall falimentin;
- Përfitimi i fondeve nga kompani të ndryshme brenda apo jashtë vendit për një shërbim të ofruar jo shumë të qartë nisur edhe nga fakti se objekti i veprimtarisë së kompanisë është i përgjithshëm;
- Qarkullimi i fondeve mes kompanive që kanë ortakë dhe administratorë të njëjtë, pa një qëllim dhe shpjegim të qartë ekonomik;
- Transferime të fondeve me qëllim likuidim të blerjes së pasurive në vlera më të larta nga ato të deklaruara në kontratat/marrëveshjet respektive të shitjes;
- Transferta hyrëse nga individë me justifikim se të ardhurat vijnë nga aktiviteti në fushën artistike/mediatike/këshilluese, duke mos paraqitur asnjë dokumentacion justifikues që të ardhurat e përfituara janë të deklaruara (DIVA);
- Transferta hyrëse nga individë me justifikim se të ardhurat vijnë nga platforma të ndryshme on-line, duke mos paraqitur asnjë dokumentacion justifikues që të ardhurat e përfituara janë të deklaruara (DIVA);
- Klient jo rezident i cili hap një llogari personale në Shqipëri dhe kryen transaksione me natyrë të ardhurash nga aktiviteti online, pa i deklaruar ato në vendin e rezidencës tatimore, ose që refuzon të paraqesë dokumentacion mbështetës që provon deklarin e këtyre të ardhurave;
- Përfitimi i transfertave në vlera të larta në llogari të kompanisë pa një qëllim të qartë, duke pasuar me kalim në llogarinë personale të ortakut/ve me qëllim final tërheqjen e tyre ose përdorimin për investime në pasuri të luajtshme apo paluajtshme;
- Qarkullime të lartë në një kartë krediti personale, që në dukje mund të tregojnë që janë me natyrë apo për qëllime biznesi;
- Transferta të përsëritura fondesh nga llogaria bankare e kompanisë drejt llogarisë personale të aksionerit, të cilat paraqiten si hua, por më pas tërhiqen në formë cash nga aksioneri dhe nuk dokumentohet kthimi apo ripagimi i tyre;

- Kryerje transaksionesh zinxhir midis disa subjekteve juridike, pa një qëllim të qartë ekonomik apo lidhje të justifikueshme tregtare ndërmjet tyre, ku kompanitë përfshihen në aktivitete që nuk kanë lidhje ndërmjetësisht në aspektin e veprimtarisë së tyre.



C. Mënyra e operimit të biznesit

Duke ju referuar praktikave dhe proceseve të ndjekura, për të drejtuar dhe menaxhuar një biznes, subjektet raportuese mund të arrijnë të identifikojnë disa indikatorë të dyshimtë.

Më poshtë paraqiten disa indikatorë që mund të konstatohen:

- Përzierja e llogarive personale dhe atyre të kompanisë. Pra, llogaritë personale mund të përdoren për të marrë pagesa/transferta që kanë të bëjnë me veprimtarinë e kompanisë, duke ulur kështu të ardhurat që duhet të deklarohen në emër të kompanisë;
- Përdorimi i strukturave komplekse jo në përputhje me natyrën dhe aktivitetin e kompanisë;
- Rritja e papritur dhe e pashpjegueshme e të ardhurave të kompanisë ose akumulim të lartë të ardhurash jo në proporcion me kompaninë e sapo themeluar;
- Krijimi i dy ose më shumë subjekteve tregtare në shtete të ndryshme, që kanë të njëjtin emër por pa qëllim tregtar;
- Struktura të pronësisë që lejojnë përdorimin e aksioneve të mbajtësit³;
- Mbajtja dhe përdorimi i shumë llogarive bankare të panevojshme, për aktivitetet e përditshme të kompanisë;
- Regjistrimi i kompanive të cilat më pas pezullohen menjëherë pas themelimit të tyre;
- Krijimi i kompanive të reja vetëm për të kërkuar rimbursim TVSH-je pa pasur një histori të mëparshme të aktivitetit ekonomik;
- Kompanitë kërkojnë rimbursime të TVSH-së për periudha të shkurtra pa treguar aktivitet të dukshëm;
- Faturat nuk përputhen me aktivitetin ekonomik të kompanisë (p.sh., mungesa e furnizuesve ose ofruesve të shërbimeve të konfirmuar) mund të jenë një shenjë e mashtrimit;
- Regjistrimi i kompanive me të njëjtin objekt veprimtarie, të njëjtën adresë dhe përfitimi i fondeve nga të njëjtët dërgues jashtë vendit dhe më pas tërheqja cash e tyre;

³ Sipas përkufizimit të FATF “Aksionet e mbajtësit” i referohen instrumenteve të negociueshëm, që i japin pronësi personit që posedon certifikatën e aksionit tek një personi juridik”.

- Përdorimi i kompanive të shumta, me qëllimin e vetëm marrjen dhe disbursimin e fondeve;
- Vlerat e deklaruara në fatura për mallra/shërbime nuk korrespondojnë me vlerën e tregut (nënvlerësim ose mbivlerësim të mallrave/shërbimeve);
- Mospërputhje mes transaksioneve të realizuara dhe llojit të aktivitetit që ushtrojnë kompanitë (referuar formës së kontratave tip, të njëjta, të nënshkruara me partnerët e huaj);
- Kompania nuk deklaron në mënyrë periodike të dhënat e saj financiare në organet përkatëse tatimore apo në regjistra publike të aksesueshëm⁴;
- Kompani/biznese që kanë vite që janë regjistruar në QKB, por që nuk kanë depozituar asnjë pasqyrë financiare/bilanc kontabël;
- Shitblerja e kuotave/aksioneve të personave juridik me një çmim më të ulët apo më të lartë, krahasuar me vlerën e kapitalit neto të shoqërisë;
- Dhënia e huave nga kompani që rezultojnë me humbje, fitim minimal fiskal apo janë në proces likuidimi, apo kur vet kompania në bilancet e saj ka deklarime për detyrime financiare (tituj huamarrje).



D. Burimi i fondeve dhe pasurisë

Indikatorë të lidhur me informacionin dhe/ose dokumentet mbi burimin e fondeve dhe pasurisë janë, si më poshtë:

- Klienti nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të japë informacion/dokumentacion mbi burimin e fondeve dhe burimin e pasurisë kur i kërkohet;
- Ka dyshime për informacionin/dokumentet e dorëzuara nga klienti, të cilat duken me anomali ose nuk janë mjaftueshëm të qarta për burimin e fondeve dhe pasurisë;
- Klienti gjatë marrëdhënies me bankën, kryen transaksione në hyrje/dalje që nuk janë në përputhje me informacionin e disponuar për burimin e pasurisë dhe të fondeve të mbajtura në dosje nga banka. Ky mund të jetë një tregues i një burimi tjetër të ardhurash që klienti nuk e ka raportuar më herët;
- Informacioni për burimin e fondeve të depozituara nuk përputhet me shërbimet që kërkohen. P.sh.: një klient me të ardhura të moderuara (mesatare), kërkon shërbime që janë më të përshtatshme për bizneset më të mëdha;
- Shitjet dhe blerjet nuk mbështeten me fatura ose dokumentacion justifikues të duhur ose ka dyshime për legjitimitetin e një dokumentacioni të tillë.

⁴ QKB, Regjistri i pronarit përfitues.

3. Tipologji

Ky kapitull paraqet tipologji dhe raste studimore vendase dhe të huaja të cilat përshkruajnë metoda, indikatorë të ndryshëm të manipulimit financiar, fshehjes së të ardhurave.

Tipologji 1: *Strukturimi i veprimeve financiare*

Kjo tipologji lidhet me një teknikë tipike dhe të zakonshme për pastrimin e fondeve të paligjshme dhe që në vetvete është një indikator: strukturimi, ku zakonisht depozitimet dhe transfertat që ndahen në shuma të vogla për të shmangur zbulimin nga institucionet financiare. Konkretisht, individët dhe subjektet mund t'i strukturojnë transaksionet e tyre në transaksione të shumta më të vogla, të kryera gjatë një periudhe kohore dhe/ose përmes vendndodhjeve dhe kanaleve të ndryshme për të shmangur tërheqjen e vëmendjes nga institucionet financiare/jo financiare. Kjo tipologji parë në kuadër të evazionit fiskal, ka të bëjë, p.sh.: me depozitime të rregullta dhe transfertat të shumave të vogla të cilat mund të jenë tregues i vendosjes në sistemin financiar të fitimeve të padeklaruara.

Indikator i në këtë rast lidhet me veprimet zinxhir, pa pasur ndonjë arsye legjitime për të ndodhur si grup transfertash apo depozitimesh të njëpasnjëshme. Kur transaksionet që ndodhin nuk kanë kuptim ekonomik, legjitim apo nuk janë për qëllime biznesi, atëherë këto transaksione mund të jenë tregues i evazionit fiskal.

Shembull: Blerja e një pasurie të luajtshme (mjet motorrik) në vlerë të lartë ose blerja e disa pasurive të paluajtshme, kur individi ka të deklaruar një pagë minimale ose deklaron të ardhura shumë të ulëta, kjo mund të jetë tregues i fitimeve/ardhurave të padeklaruara. Brenda një konteksti biznesi, mund të jepet një shembull tjetër, si p.sh.: gjenerimi i të ardhurave si tarifa konsulence, kur kompania që dihet se nuk ofron ndonjë shërbim të tillë dhe as që ka ndonjë eksperiencë ose përfshirje në një fushë të tillë.

Tipologji 2: *Transaksione financiare nga kompani pa aktivitet real ekonomik*

Kjo tipologji ka të bëjë me realizimin e transaksioneve financiare nga kompani pa aktivitet real ekonomik. Disa indikatorë kryesorë të kësaj tipologjie përfshijnë:

- Regjistrimi në një juridiksion të largët: kompania është krijuar në një vend ku nuk ka veprimtari të vërtetë apo staf të dedikuar;
- Qëllimi i fshehjes së fondeve: Këto kompani përdoren për të shmangur detyrimet tatimore ose për të vështirësuar gjurmimin e të ardhurave, duke krijuar një shtresë shtesë komplekse ndërmjet fondeve dhe pronarëve të vërtetë;
- Lëvizja e fondeve ndërkombëtare: Ato shërbejnë si mekanizma për të transferuar para nga një juridiksion në tjetrin, shpesh duke përdorur transfertat komplekse për të fshehur origjinën dhe destinacionin final të fondeve;

- Shmangia e tatimeve dhe rritja e kostove artificiale ku kompanitë krijojnë shpenzime të fryra ose të rreme për të ulur fitimet dhe për të minimizuar detyrimet tatimore në vendin ku aktiviteti real ndodh.

Tipologji 3: *Financimi i kompanive nëpërmjet huave të aksionarëve*

Kjo tipologji lidhet me skemat e financimit të kompanive ku aksionarët ofrojnë hua për të mbështetur aktivitetin e kompanisë, shpesh duke bërë derdhje me cash direkt në arkën e kompanisë dhe duke anashkaluar sistemin tradicional bankar ose duke krijuar struktura financiare që mund të përdoren për evazion fiskal, pastrim parash apo manipulim të pasqyrave financiare.

Karakteristikat kryesore të kësaj tipologjie janë:

- Hua të përsëritura nga aksionarët: kompania merr vazhdimisht hua nga aksionarët e tij, shpesh pa një justifikim të qartë ekonomik;
- Ka një mospërputhje mes profilit të aksionerit dhe shumave të dhëna hua: Vlerat e huave nuk përputhen me burimet e njohura financiare të aksionarit, duke ngritur dyshime mbi origjinën e fondeve;
- Kushte të favorshme për huatë: Interes të ulët ose të papërcaktuar, mungesë garancish, afate të gjata kthimi ose madje falje të borxheve në mënyrë të përsëritur;
- Mungesa e një nevoje të vërtetë për hua: Kompania mund të ketë akses në burime financiare të tjera ose të mos ketë një arsye të justifikueshme për të marrë hua të tilla;
- Huatë përdoren për të kanalizuar fonde: Kjo mund të bëhet për të shmangur taksimin e dividendëve, për të transferuar para ndërmjet juridiksioneve ose për të fshehur burimin e fondeve;
- Huatë e marra përdoren për të bërë transferta ndërkombëtare pa një qëllim të qartë ekonomik;
- Aksionarët e huadhënësit kanë lidhje me juridiksione të njohura për lehtësira tatimore ose mungesë transparence financiare.

Tipologji 4: *Nënvlerësim ose mbivlerësim të çmimit të mallrave/shërbimeve*

Tipologjia që lidhet me "Nënvlerësimin ose mbivlerësimin e mallrave/shërbimeve dhe kur vlerat e deklaruar në fatura nuk korrespondojnë me vlerën e tregut", ka të bëjë me praktikën e pasaktësive ose manipulimeve në vlerësimin e mallrave dhe shërbimeve, dhe mund të nënkuptojë përpjekje për të fshehur informacion të vërtetë mbi transaksionet për të shmangur taksat ose për të krijuar një pamje të rreme të financave të kompanisë.

Tregues të pasaktësisë në fatura:

- Faturat me përshkrime të paqarta ose të pa detajuara (p.sh.: "materiale të ndryshme" në vend të një përshkrimi specifik të mallrave);
- Faturat që nuk përputhen me natyrën e transaksionit (për shembull, një shërbim i ofruar në një kohë të papërshtatshme, që duket i pazakontë ose i dyshimtë në kontekstin e biznesit);
- Faturat e lëshuara në fund të vitit, kur shërbimi është kryer disa muaj më parë, mund të jenë një mënyrë për të shtyrë fitimet për një periudhë tjetër tatimore;
- Përdorimi i faturave për mallra që nuk janë dorëzuar ende ose shërbimeve që nuk janë ofruar ende për të krijuar pasuri të dukshme në raportet Financiare;
- Faturime për shërbime të ndryshme, si p.sh.: juridike, teknike, arkitekturore, konsulenca apo shërbime marketing, studime tregu apo punime shkencore, etj., të cilat nuk kanë njësi dhe sasi matëse ku materializohet qartë që transaksioni është kryer në funksion të aktivitetit ekonomik.

Tipologji 5⁵: Dyshime për evazion fiskal

Një institucion kredidhënës dërgoi informacion të dyshimtë në FIU për një individ, i cili dyshohej për të ardhurat e tij të deklaruara në organet tatimore. Nga rishikimi periodik i llogarisë së kompanisë të individit u identifikuan shuma të kaluara nga llogaria bankare e kompanisë tek llogaria personale e individit, në të njëjtën bankë. Përshkrimi për këto kalime ishin deklaruar si 'shlyerje kredie për aksionerin' dhe për këtë qëllim u kërkuar dokumentacioni justifikues për këto pagesa. Individui hezitonte të siguronte dokumentet, që e shtynë institucionin kredidhënës të kërkonte një takim ballë për ballë me klientin.

Individi paraqiti pas insistimit, pasqyrat financiare si dhe deklaratat tatimore përkatëse. Pas një analize të detajuar të dokumentave, subjekti raportues zbuloi se të ardhurat e deklaruara për vitin ishin përafërsisht 1 mld Lek, ndërsa totali i kredive në llogarinë bankare ishte shumë më i lartë, 1.2 mld Lek. Në kuadër të raportit të dyshimtë të dërguar, FIU kreu analiza të mëtejshme në llogaritë e tjera bankare të individit, si dhe bëri një rishikim të pronave që ishin blerë po nga individit. Rasti u referua në institucionet ligjzbatues me dyshimin për mosdeklarim të të ardhurave të kompanisë ose kryerje të evazionit fiskal.

Indikatorët:

- Kombinimi i fondeve midis llogarive personale dhe llogarive të kompanisë. Një rast tipik mund të jetë p.sh.: në rastet kur kemi një përdorim të llogarive personale për

⁵ Rastet studimore 1.2.3 janë marrë nga site: <https://fiaumalta.org/app/uploads/2021/11/FIAU-Factsheet-Typologies-Red-Flags-Indicators-of-Tax-Related-ML.pdf>

transaksione biznesi kur individi ka një personi fizik të regjistruar në organet tatimore si PF;

- Klienti nuk bashkëpunoi me punonjës të subjektit raportues;
- Pagesat e shumta të depozituara në llogarinë personale bankare dhe të shënuara si shlyerje kredie për aksionerin;
- Nëndeklarimi i të ardhurave të kompanisë.

Tipologji 6: *Transaksione të dyshimta nga kompani të regjistruara në vende të ndryshme*

FIU ka marrë një raportim të aktivitetit të dyshimtë nga një institucion kredihënës nisur nga fakti se Kompania A (me aktivitet tregtar ‘Ofrim shërbime konsulence financiare dhe për investime’) ka kërkuar të transferonte 37,000 Euro tek Kompania B, e regjistruar në Shtetin L. Shtetasi X (pronari fundor përfitues (PFP) i Kompanisë A) ka deklaruar se transferta e kryer ishte për shlyerjen e një kredie midis Kompanisë A dhe Kompanisë B. Duhet theksuar se Shtetasi X është njëkohësisht pronar përfitues i Kompanisë A, Kompanisë B dhe Fondacionit C. Gjithashtu, shtetasi X është edhe një nga ortakët e Kompanisë V, e regjistruar në Shtetin M, e cila është një firmë ndërkombëtare konsulence financiare.

FIU analizoi transaksionet bankare (*ku bashkëpunoj edhe me FIU homologe*), nga ku u identifikua se fondet pasi dërgoheshin nga Kompania A, më pas transferoheshin tek llogaritë e kompanive të tjera ku shtetasi X ishte PFP ose drejt llogarive personale të mbajtura nga vetë shtetasi X, që ishin të regjistruara në vende të huaja.

Njëkohësisht, FIU vuri re se Kompania A dhe Kompania V kishin blerë secila më vete nga një pasuri të paluajtshme në vlera të konsiderueshme, gjë e cila nuk lidhet me natyrën e aktivitetin që këto dy subjekte kanë.

Nga bashkëpunimi me homologët e FIU në shtetin M, rezultoi se:

- Shtetasi X nuk kishte deklaruar të ardhurat me burim të huaj, në shtetin M;
- Ka dyshime që shtetasi X po përdor Shqipërinë për të kryer evazion fiskal;
- Në shtetin M rezulton të jenë raportuar deklarata minimale të të ardhurave.

Indikatorët:

- Regjistrimi/Themelimi i kompanive në disa shtete;
- Blerje që nuk janë në përputhje me aktivitetin tregtar të kompanisë;
- Pagesat e depozituara në llogaritë bankare personale dhe të kompanisë, të përshkruara si kredi aksionere;
- Kalimi i fondeve midis llogarive personale dhe atyre të kompanisë;

- Indikacione për mos deklarim të saktë të fondeve në organet tatimore.

Tipologji 7: *Veprime në vlera të larta jo në përputhje me profilin financiar të kompanisë*

Në shtator 2021, një subjekt bankar raportoi në FIU për një shtetas vendas, i cili kryente transaksione të dyshimta dhe që mund të kishin në lidhje me evazion fiskal. Sipas raportimit, rezultoi që individi zotëronte një kompani që kryente qarkullime të shpeshta në para fizike (cash).

Dyshimet lindën kur shtetasi tentoi të kryente depozitime bankare të shumta, (për një periudhë 3 mujore) 7 herë më të madhe se të ardhurat e deklaruara vjetore.

Verifikimet e kryera nga FIU

FIU kërkoi informacion të plotë për transaksionet bankare të individit, me qëllim për të kryer një analizë më të detajuar. Gjithashtu, u morën deklaratat tatimore dhe të dhënat për kontributet e sigurimeve shoqërore.

Pas analizimit të të dhënave, u konstatua se depozitimet e kryera nga kompania ishin dukshëm më të larta se fitimet e deklaruara në databazën e tatimeve dhe QKB, ç’ka krijonte dyshime për të ardhura të padeklaruara.

Pas përfundimit të analizës, FIU dërgoi rastin për investigim të mëtejshëm në organet ligjzbatuese.

Tipologji 8: *Transaksione të dyshimta nga një shoqëri telemarketingu⁶*

Kompania A, e regjistruar në QKB në vitin 2015, ushtron aktivitetin e saj në fushën e ofrimit të shërbimeve të marketingut në internet (call center, teleselling) dhe sipas të dhënave të disponuara, rezulton se:

- Kompania A, është themeluar nga shtetasi shqiptar X dhe një shtetas i huaj Y,
- Në vitin 2016, shtetasi i huaj Y i ka shitur kuotat e tij bashkë ortakut shtetasit shqiptar X, i cili bëhet ortak i vetëm i Kompanisë A,
- Një vit më vonë, në vitin 2017, ortaku i vetëm shtetasi X ia ka shitur kuotat shtetasit G,
- Kjo kompani po në vitin 2017 kalon në statusin “pezulluar”.

Në vitin 2018 është themeluar një Kompani tjetër “A-1” nga shtetasi F, djali i shtetasit G dhe familjar i afërt i shtetasit X.

⁶ RV 2018 AIF

- Gjatë këtij viti Kompania “A-1” ka përfituar disa transfertë në vlera të konsiderueshme (~160,000 Euro), nga kompania B me seli në një vend M, të njohur si parajsë fiskale,
- Në vijim ka patur tërheqje nga llogaritë në vlera të konsideruara cash nga administratorët e Kompanive “A” dhe “A-1”,
- Nga verifikimet e kryera rezultuan lidhje të shtetasve të përfshirë në transaksione dhe biznese, me subjekte për të cilët AIF ka dërguar më parë informacion në agjencitë ligjzbatuese me dyshime për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale.

Për Kompaninë A nga kërkimet e kryera rezultuan të dhënat, si vijon:

- Likujtime të detyrimeve nga Kompania A, në favor të një sërë kompanish të tipit ‘person fizik’ të regjistruara rishtazi nga disa shtetas të ndryshëm, pa ndonjë lidhje të njohur me Kompaninë apo ortakun e saj,
- Këta persona fizik tregtar përfitues të fondeve (pra, ofrues të shërbimeve) janë regjistruar në QKB në të njëjtën periudhë të vitit (madje disa prej tyre në të njëjtën ditë) dhe me të njëjtin objekt ‘shërbime online’.

Nga verifikimet fiskale për këto subjekte, rezultoi se:

- Faturat e tyre janë për shërbime vetëm në favor të subjektit A,
- Faturat në disa raste të disa personave fizik, janë fatura mujore të gjitha në numër rendor të njëpasnjëshëm në favor të Kompanisë B dhe në vlera jo të larta,
- Kompanitë persona fizik të regjistruar në 2017 faturën e parë Nr.1, kanë të gjitha shërbime në favor të Kompanisë B dhe me një vlerë të lartë.

Fondet e përfituara nga faturimi në emër të tyre duke i njohur si shpenzime, më tej janë tërhequr në cash.

Elementët e dyshimtë e konstatuar janë:

- Dërgimi i transfertave nga Kompania A në favor të disa kompanive të tipit ‘person fizik’, të cilat janë krijuar në të njëjtën periudhë njëra pas tjetrës dhe me të njëjtin objekt, dukshëm fiktive,
- Përfitimi i fondeve në vlera të konsiderueshme të Kompanive A dhe A-1 nga një urdhërues i vetëm, kompani me seli në një vend të njohur si parajsë fiskale,
- Paqartësi në objektin të aktivitetit të llojit të shërbimeve të konsulencës së marketingut të ofruar nga kompanitë e cituara më sipër,
- Tërheqjet në cash në vlera të larta të pajustificuara për aktivitetin e biznesit që kryhet,

- Përfshirjen e hershme të familjarëve të ngushtë të administratorit të A-1 në kompaninë ‘call center’ edhe këto të referuara në lidhje me dyshime për fondet e qarkulluara.

Tipologji 9⁷: Përfitim i transfertave të vlera të larta dhe tërheqja cash e tyre

Shtetasi i huaj X në më pak se 1 vit hap 4 kompani në Shqipëri që kanë aktivitet në fusha që lidhen me ndërtimin, import-eksport mallrash të veshjeve, shitblerje pasurish të paluajtshme, si dhe zhvillim të biznesit, për të cilat hap llogari në banka të ndryshme.

Në llogaritë bankare të disa prej këtyre kompanive, u vunë re transferta në vlera të konsiderueshme të dërguara nga vende të cilësuar me risk të lartë për pastrim parash, mes të cilave veçojmë:

- Kompania A për periudhën Janar - Mars 2020 ka përfituar 450,000 Usd nga një kompani me vendndodhje në shtetin 1, pjesa më e madhe e të cilave (330,000 Usd) tërhiqen në para fizike nga vetë shtetasi duke deklaruar se këto fonde do të përdoren për blerje kompjuterash, makina të ndryshme dhe produkte mjekësore në Shqipëri dhe në një vend fqinj. Në mars 2020, kompania ‘A’ transferon 70,000 Euro në një vend të rajonit për blerje produktesh që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe një pjesë të fondeve të kredituara në llogarinë e subjektit janë përdorur për blerje me kartë (POS).
- Nga komunikimi me NJIF partnere është konstatuar se, kompania A gjatë një periudhe dy vjeçare në llogaritë që disponon në shtetin 1, ka përfituar dhe dërguar transferta bankare nga dhe për subjekte të ndryshme po në shtetin 1, në vlera të larta që arrijnë në një total prej 4,000,000 Usd.
- Kompania B, për periudhën Janar-Maj 2020 ka përfituar 110,000 Euro të urdhëruara nga subjekte të ndryshme nga vendet 2, 3, 4 dhe 5 me përshkrim “për shitblerje malli, maska, doreza”. Më pas fondet e kredituara transferohen në favor të kompanive të ndryshme në SHBA dhe Kinë për pagesë faturash, një pjesë përdoren për blerje me kartë (POS) të produkteve të ndryshme por edhe të shërbimeve që lidhen me fushën e IT. Blerjet realizohen në vende të ndryshme të botës.

Kompania B ka deklaruar pranë subjekteve financiare se importon mallra nga një vend i rajonit dhe një vend i BE dhe më pas i eksporton në varësi të kërkesave. Nga verifikimet e AIF rezultoi se asnjë prej kompanive të shtetasit X, nuk kishte kryer procedura doganore import/eksporti.

⁷ RV 2021 AIF

Gjithashtu, për shtetasin X rezultuan të dhëna për mashtrim, për shkak se ky shtetas premtojte shitje të produkteve të ndryshme kundrejt pagesave bankare, por malli për të cilin ishte rënë dakord nuk ju lëvrohej klientëve.

Nga verifikime të mëtejshme, rezultoi se:

- Kompanitë e shtetasit X, nuk kishin aktivitet tregtar në vendin tonë (pa punonjës dhe për më tepër pa aktivitet shit-blerje);
- Adresat e subjekteve nuk janë të sakta dhe bizneset nuk ekzistojnë;
- Shtetasi X, nuk kishte hyrje-dalje të regjistruara në vendin tonë;

Elementët e dyshimtë e konstatuar janë:

- Themelimi i Kompanive të ndryshme brenda një periudhe të shkurtër kohore nga një shtetas i huaj me një profil jo të qartë;
- Transferta të larta në mbërritje të pasuara me tërheqje të fondeve apo blerje me kartë;
- Fonde të përfituara në formën e pagesave të faturave, ndërkohë që subjekti përfitues nuk ushtronte aktivitet financiar;
- Indiciet për mashtrim.

Tipologji 10⁸: *Transaksione të dyshimta nga një kompani me lidhje me PEP*

Shtetasi A bashkëshort i shtetases B, ish-PEP në pozicion të lartë drejtues në një institucion publik X, rezultonte të kishte nënshkruar disa kontrata noteriale huaje, në cilësinë e palës huamarrëse me qëllim jo të qartë për sa i përket marrjes dhe përdorimit. Si huadhënës, shfaqeshin shtetas të njohur për AIF, si të përfshirë në dyshime për pastrim parash.

AIF kreu verifikime të mëtejshme nga ku rezultoi se shtetasi A kishte regjistruar një kompani “DX”, që ushtronte veprimtari në fushën e ndërmjetësimit.

Kompania “DX” më tej lidh një kontratë huaje nëpërmjet së cilës do t’i huazonte vlerën prej 40,000 Euro një kompanie tjetër “EX”, e cila do të kryente një pagesë në favor të një institucioni publik për një leje të miratuar në favor të Kompanisë. Verifikime të mëtejshme treguan se leja e miratuar, lidhej drejtpërdrejtë me interesat pasurore të shtetasit A.

Më tej, shtetasi A bleu shumicën e kuotave të Kompanisë “EX” (të cilës i kishte dhënë hua nëpërmjet Kompanisë “DX”) në vlerë 1 milion Euro, duke përforcuar dyshimet për krijimin e një skeme me qëllim humbjen e gjurmëve lidhur me përfituesit fundor të lejes, mënyrës së grumbullimit të fondeve dhe arsyt e huadhënies në favor të një subjekti, të cilit i mungonte eksperiencia e duhur në sipërmarrjen e iniciuar rishtazi.

⁸ RV 2020 AIF

Elementët e dyshimtë e konstatuar janë:

- Krijimi i një veprimtarie ekonomike në një fushë që nuk përputhej me profilin e mëparshëm të individit;
- Investimi në një kompani të dytë, e cila më herët kishte përfituar nga një leje e dhënë nga një Ent Publik;
- Origjina e huazuar e fondeve nga kompani me profil të dyshimtë dhe përdorimi për investimet e kryera në veprimtarinë e biznesit;
- Lidhja familjare me një ish-PEP.

Tipologji 11⁹: *Blerje dhe rishitje me vlerë dukshëm më të lartë të pasurisë së paluajtshme*

Në shkurt 2021, shtetasi A (*i cili zotëron një kompani me qarkullim vjetor nën 1.4 mln Lek*) ka blerë një pasuri të paluajtshme të llojit truall me sipërfaqe 1,500 m², me çmim 30,000 Usd. Dy muaj më pas, shtetasi ka bërë fillimisht rivlerësimin e pronës në vlerën 240,000 Usd dhe më pas ia ka shitur truallin një biznesmeni që operon në fushën e ndërtimit me të njëjtin çmim (240,000 Usd).

Pra, brenda 2 muajsh pronën e blerë për vetëm 30,000 Usd e ka shitur me një çmim 8-herë më të lartë, ndërkohë që nga verifikimet e kryera nuk rezultoi që mbi këtë truall të ishte realizuar investim, i cili mund të kishte ndikuar në rritjen e vlerës së pasurisë.

Gjithashtu në vijim, në prill 2021 shtetasi A mori hua 80,000 Euro nga shtetasi B (*i angazhuar në aktivitet privat në fushën e shërbimeve*), me qëllim blerjen e një pasurie të luajtshme (automjet). Shtetasi B i ka gjeneruar fondet e dhëna hua nga shitja e një pasurie të paluajtshme të llojit *‘tokë arë me sipërfaqe 30,000 m²’*, tek blerësi shtetasi C (*biznesmen në fushën e ndërtimit*) me çmim 150,000 Euro. Pas marrjes së huasë, shtetasi A ka blerë një autoveturë me çmim 80,000 Euro tek shtetasi C dhe disa ditë më vonë ia ka shitur mjetin shtetasit B, tek i cili u financua më herët me hua.

Elementët e dyshimtë e konstatuar janë:

- Shitje e pasurisë së llojit ‘truall’ me një çmim 8-herë më të lartë nga çmimi i blerjes;
- Kompleksiteti i transaksioneve të ndërsjella mes tre palëve, ku fillimisht shtetasi **B** i shet truall shtetasit **C** dhe një pjesë të fondeve të përfituara (80,000 Euro) ia jep hua shtetasit **A**, i cili i përdor këto fonde për blerje autoveture tek **C** dhe më pas autoveturën ia shet **B**;
- Rezultatet financiare të shtetasit A dhe familjarëve të tij, nuk i justifikojnë shumat e larta të qarkulluara prej tij.

⁹ RV 2021 AIF

Referencat:¹⁰

- <https://fiaumalta.org/app/uploads/2021/11/FIAU-Factshët-Typologies-Red-Flags-Indicators-of-Tax-Related-ML.pdf>
- [2020 Public Bulletin Money Laundering of Serious Tax Crimes.pdf](#)
- <https://fid.gov.lv/uploads/files/2023/Indicators%20of%20ML%20in%20Outsourced%20Accountant%20and%20Tax%20Consultant%20Sectors.pdf>
- [STRATEGIC ANALYSIS REPORT 2020-2021](#)
- [Raportet Vjetore – Agjencia e Inteligjencës Financiare](#)

¹⁰ Materialet e përdorura: Money Laundering of Serious Tax Crimes (Enhancing Financial Intelligence Units' Detection Capacities and Fostering Information Exchange), *Burimi*: Egmont Group & IEWG; Indicators of Money Laundering in Outsourced Accountant and Tax Consultant Sectors 2024, *Burimi*: FIU Latvia; Strategic Analysis Report 2020-2022, *Burimi*: FIU Cyprus; Typologies & Red Flags – Indicators of Tax Related ML, *Burimi*: FIU Malta; Raportet Vjetore 2018-2024, *Burimi*: FIU Shqipëri.